



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:849/25 Datë: 10.07.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 139 të mbajtur më 30.06.2025, mori:

V E N D I M

I. Nuk riakreditohen programet e studimeve në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan.

1. *Juridik i Përgjithshëm, LLB 240 ECTS (R);*
2. *Juridik Penal, LLM 60 (R);*

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan, brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Juridik i Përgjithshëm, LLB 240 ECTS (R);</i>	Sadik Haxhiu Dukagjin Leka Albulena Hajdari Krasniqi Fadil Osmani Ardian Emini dhe Detrina Alishani Sopi
2.	<i>Juridik Penal, LLM 60 (R);</i>	Fatmire Krasniqi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelor dhe Master (tutje Manualit).

Ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; Juridik i Përgjithshëm, LLB 240 ECTS (R); vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 25.02.2025.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht përmbush dy (2) fushë të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit;
- Pjesërisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit;
- Nuk i përmbushë kriteret, një (1) fushë të standardeve të akreditimit;

2. Për programin e studimit; Juridik Penal, LLM 60 (R); vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 25.02.2025.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht përmbush një (1) fushë të standardeve të akreditimit;
- Pjesërisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit;
- Nuk i përmbushë kriteret, dy (2) fushë të standardeve të akreditimit;

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 139-të, të mbajtur më datë 30.06.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin relevant të riakreditimit për programet e lartë përmendura të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, vlerësimin, si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtoj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë